Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-73
Datë: 13.02.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Nr. 09/2019 për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 23.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Përfundon procedimi administrativ i filluar me kërkesën e parashtruar nga Prime Education me numër protokolli Nr.Prot.01/631 datë 18.10.2022, për aplikim në procesin e akreditimit për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak për kualifikimet:

a. *Instalues Elektrik, Niveli IV i KKK,*
b. *Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit, ujit dhe Kanalizimit Niveli IV i KKK si dhe*
c. *Metalpunues Niveli IV i KKK.*

II. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Institucioni Prime Education ka paraqitur kërkesën me Nr.Prot.631/23 datë 18.10.2022 për aplikim në procesin e akreditimit për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) për kualifikimet e cekura në pikën 1 të këtij vendimi. AKK ka dërguar njoftimin për realizimin e vizitës tek institucioni pas aprovimit të dosjes nga KD, institucioni Prime Education është njoftuar për shpenzimet dhe përbërjen e ekipeve vlerësuese. Me këtë rast institucioni Prime Education pas pranimit të njoftimit me datë 4 Maj 2023 ka bërë kërkesë që vizita të shtyhet për arsye të kapaciteteve të praktikuesve të NjMP të cilët duhet të ishin e certifikuar nga AKK. AKK në muajin Korrik 2023 ka organizuar trajnimin për ngritjen e kapaciteteve ku ka ftuar stafin e institucionit Prime Education për tu certifikuar për rolin e tyre në NjMP.

Në muajin Tetor AKK ka përsëritur njoftimin për realizimin e e vizitës, shpenzimet dhe përbërjen e ekipeve vlerësuese dhe përsëri institucioni nuk ka qenë i gatshëm që të realizohet vizita për procesin e akreditimit për zbatimin e NjMP.

Me datë 24.06.2024 raporti i ekspertëve për këtë institucion për procesin e validimit të kualifikimeve me rekomandim për mos aprovim të kualifikimeve dhe mos akreditim të institucion është shqyrtuar dhe është marr vendimi nga KD. Referuar kësaj pas marrjes së vendimit për mos aprovim të kualifikimeve Institucioni përsëri ka kërkuar që të realizohet vizita në kuadër të procesit për akreditim për zbatimin e NjMP dhe ka

dorëzuar edhe kërkesën për të plotësuar kriteret e validimit të kualifikimeve me datë 18.09.2024 dhe nr. të protokollit 01/577.

Referuar kërkesës me datë 18.09.2024 nr.01/577 për përditësimin e dosjes së aprovuar duke i shtuar edhe materialet për plotësimin e kritereve për validimin e kualifikimeve, dhe rrethanat e krijuara si dhe duke pasur parasysh nenin 104 në ndërlidhje me paragrafin 3 të nenit 97 dhe 98 të Ligjit Nr. 05/L-031 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, i cili përcakton se; *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"* .

*P*ër arsye se dosja e aprovuar e vitit 2022 nuk plotëson kriteret e U.A. 35/2014, Neni 6 për kriteret dhe procedurat e aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve, dhe se për të njëjtën kanë kaluar të gjitha afatet procedurale të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Këshilli Drejtues i AKK, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe kompetencat ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:
Institucionit Prime Education
Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK